

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“DANA COMPANY” sh.p.k.

Sot në Tiranë me datë 11.11.2023, unë Denis Shehi, i identifikuar me karte identiteti me numer personal J20820121C, lindur në datë 20.08.1992 në Tirane dhe banues rezident në Vorë-Gjokaj, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me cilësinë e ortakut themelues, deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“DANA COMPANY” shpk**,

Neni 1.

Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin **“DANA COMPANY” shpk**, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3

Selia

Shoqëria **“DANA COMPANY” shpk** e ka seline në adresë: Rruga “Dalip Topi” banesë private Nr. 255, Njësia Administrative Dajt, Tirana dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4

Objekti i veprimitarise

- a. Objekti i ushtrimit të veprimtarise per shoqërine **“DANA COMPANY” shpk** është per te gjitha llojet e punimeve dhe investimeve **Ne fushen e ndertimeve civile, industriale, turistike etj**, shoqeria do te kryeje supermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin, me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: ndertimin e ndertesave publike dhe private me gjitha llojet, pa asnje kufizim te punimeve dhe konstruksioneve, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, portet, aeroportet, traseve hekurudhere, ujesjellesave, kanalizimeve, veprave ujite, objektet e kultit, si dhe cdo ndertim tjeter. Supermarrje, investime dhe instalime per energjine dhe telekomunikacionet.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 100,000 lekë, i ndarë në 1(nje) kuote e cila zotërohet si më poshtë:

Denis Shehi, i identifikuar me karte identiteti me numer personal J20820121C, lindur në datë 20.08.1992 në Tirane dhe banues rezident në Vorë-Gjokaj, zoteron 1 (nje) kuote ose 100% te kapitalit të shoqerise.



Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8
Organji Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çeshtjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zgjedhimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gi) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9
Administrimi

Administrator i shoqërisë **“DANA COMPANY” shpk** është:

Denis Shehi, i identifikuar me karte identiteti me numer personal J20820121C, lindur në datë 20.08.1992 në Tirane dhe banues rezident në Vorë-Gjokaj.

Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar. Data e emërimit te tij përkon me datën e themelimit te shoqerisë që eshte data 11.11.2023.

Afati i emërimit te administratorit eshte deri me 11.11.2028.

Neni 10
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare". Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 kopje, në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera te njëjta iuridike.

Akti i mësiperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortaku themelues të shoqërisë tregtare **“DANA COMPANY” shpk**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinalë.

ORTAKU THEMELUES DENIS SHEHI

Tiranë, më datë 11.11.2023

 Denis Shechtman Tira